



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E KORÇËS

Korçë, më datë 28/10/2019

Proces-verbal nr. 2

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 20-26 tetor 2019 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me banorët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe Administratorët e Njësive përkatëse.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : Rikonstruksioni qendrave shëndetësore dhe disa shkollave në fshatra, ndërtimi i Bibliotekës së Re, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë, ndriçimin public, rehabilitimin e rrjetit të brendshëm rrugor në fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të banorëve për investimet gjatë vitit në vazhdim në mënyrë që t’ju jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që Bashkia e Korçës duhet ti shohë me përparësi, banorët patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2020. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

Takimet e zhvilluara:

22 tetor Njësia Administrative Drenovë
25 tetor Njësia Administrative Voskop
26 tetor Njësia Administrative Vithkuq
25 tetor Njësia Administrative Bulgarec
23 tetor Njësia Administrative Mollaj

26 tetor Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas

Bazuar në kërkesat e ngritura nga banorët dhe kryetarët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

DRENOVË

- **Fshati Mborje:** rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, sistemimi i pusetave për ujërat e shiut, ndërtimi i unazës.
- **Fshati Ravonik:** Rikonstruksioni i rrugës në hyrje të fshatit, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore, rehabilitimi i fushës së mbetjeve.
- **Fshati Turhan:** rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm rrugor.
- **Fshati Drenovë:** sistemimi i rrugëve dytësore dhe nxitja e turizmit.

(XXX): Në fshatin Mborje janë të domosdoshme investimet për ujësjellësin dhe vënien në funksion të depos së ujit, dhe ndërtimi i unazës së fshatit. Duhet të ndërhyri që ujësjellësi të mos menaxhohet më fshatçe. Janë edhe disa ndriçues të djegur që duhet ti zëvendësoni.

(XXX): Në fshatin Ravonik janë të domosdoshme investimet për ujësjellësin dhe vënien në funksion të kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatit dhe i qendrës shëndetësore.

(XXX): Në fshatin Ravonik Ju lutemi duhet të nisni punën për të rehabilituar fushën e mbetjeve. Duhet pastruar atz dhe të gjelbërohet siç keni premtuar. Na ndërtoni edhe një kënd ne pleqve diku.

(XXX): Në fshatin Turhan Kemi nevojë të bëhet rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kemi akoma se disa janë ygjudhur por disa duhen rregulluar në sistemin e kanaleve kullues dhe vaditës. Edhe rrugët e brendshme të fshatit duhet t'i zgjidhni. Duhet asfaltuar se na mbyti balta kaq vite.

(XXX): Në fshatin Drenovë janë disa rrugë që duhen sistemuar në fshat dhe turizmi duhet të ndjehet. Nuk ka ende asgjë konkrete që edhe ne si banorë të ndjehemi që turizmi po merr zhvillim.

VOSKOP

- **Fshati Voskop:** Tek rruga poshtë fshatit duhen disa sistemime por edhe në rrugët e parcelave ka akoma punë. Ndriçimi duhet shtuar, janë disa shtylla që duhet ti vendosni sepse është një rrugë e gjitha pus.

(XXX): Në fshatin Polene duhet të sistemoni rrugën që e lidh me Dërsnikun, sidomos tek fusha e sportit është shumë keq. Edhe rrugët e brendshme të fshatit që nuk I bëtë vjet duhet ti bëni këtë vit.

(XXX): Jam banor I fshatit Dërsink. Kemi akoma të pazgjidhur problemin e tokave, nuk jemi pronarë. Rrugët e lagjes poshtë nuk I keni rregulluar. Edhe tek Xhamia, ajo si urë metalike që mbulon kanalin është amortizuar.

(XXX): Në fshatin Goskovë duhet të ndërhyri për rrugët dhe ndriçimin. Edhe ujësjellësin siç e dini që e kemi të amortizuar. Në pjesën e parcelave duhen disa ndërhyrje të vogla që ja tregojmë z. Ilir më saktë vendin sepse nuk janë gjë e madhe dhe mund të na I zgjidhni shpejt.

MOLLAJ

- **Fshati Ujëbardhë:** ujësjellës I ri për fshatin, rikonstruksioni I rrugëve dhe vendosja e ndriçuesve
- **Fshati Dvoran:** Heqja e bagëtime
- **Fshati Floq:** ndërtimi I ujësjellësit të ri ose rikonstruksioni I rrjetit ekzistues
- **Fshati Kamenicë:** ndërtimi I rrjetit të kanalizimeve, vaditja e tokave
- **Fshati Pulahë:** rehabilitim I rrugëve të parcelave dhe ujësjellës I ri

(XXX): Në fshatin Kamenicë DUHET TË NDËRHZNI TEK RRUGA QË LIDH FSHATIN ME Tumën, edhe rruga që të çon lart në fshat do ndërhyrje.

(XXX): Unë jam nga fshati Floq. Së pari ne kemi akoma problem nga termeti. Dëmshpërblimet kur do ti marrim? Listat kanë përjshtuar disa persona. RRugët duhen sistemuar, janë në gjendje skandaloze. Vini dorë ju lutem. Lagjia lart është në kushte të tmerrshme as ndriçim nuk ka.

(XXX): Jam kryeplaku i fshatit Dvoran. Janë disa rrugë në fshat që duhen bërë sepse vetëm kryesoret kemi me asfalt. Edhe ju lutemi shumë ujësjellësin na e bëni sa më parë. Edhe ndonjë gjë për rritjen e tregut se ne jemi prodhues siç e dini por shumë herë I hedhim. Jo vetëm për mollën por edhe kumbullën dhe qershinë.

VITHKUQ

(XXX): Jam banor i fshatit Vithkuq. Ne kemi problem me ujin e pijshëm siç e dini, kur do na e zgjidhni. Shkolla do ndërhyrje se është e dëmtuar. Me mbeturinat kemi problem.

(XXX): Në fshatin Shtyllë ju lutemi na sistemoni lumin. Edhe disa rrugë I kemi të parregulluara.

(XXX): Në fshatin Panarit e para në dimër mos na lini të izoluar se çdo vit na bllokohet rruga. Ndriçim na duhet se s'kemi fare dhe pastrami. Edhe një lulishte si gjithë fshatrat ta kemi ne në qendër.

BULGAREC

(XXX): Në fshatin Bulgarec na rregulloni vatrën e kulturës. Kemi rrugët e brendshme të fshatit që nuk janë bërë të gjitha dhe uji I pijshëm.

(XXX): Në Biranj investimet që duhet të na bëni janë rrugët, ndriçimi nuk është kompletuar dhe kemi shqetësime nga bagëtitë që mbahen Brenda në fshat.

(XXX): Jam kryeplaku I fshatit Çiflig. Kemi disa rrugë parcelash që duhen sistemuar dhe shkolla e fshatit. Edhe në fusha e sportit po bëtë ndonjë rregullim mirë. Brenda mundësive edhe disa stola atje në qendër.

(XXX): Në fshatin Barç kemi shumë problem që nuk na I zgjidhni. Kemi rrugët që janë tmerr, fëmijët venë në shkolla në Korçë sepse shkolla e fshatit ju e dini vetë. Lagjet lart nuk keni vënë dorë për asnjë gjë. Keni bërë vetëm me asphalt dy rrugë. Merrni masa se jemi si në mesjetë.

(XXX): Jam kryeplaku I fshatit Kuç. Në fshatin tonë janë bërë ndërhyrje, disa janë në vazhdim si sitemimi I rrugëve mes parcelave, rrjeti vaditës dhe kullues është rehabilituar por kemi edhe disa punë të papërfunduara. Fusha e sportit dhe sitemimi I pjesës së varrezave të fshatit.